

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr.436, datë 16.6.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.538, DATË 26.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL), DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 36 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kategorinë IV.1 "Minerare ose hidrokarbure" të aneksit I, që i bashkëlidhet vendimit nr.538, datë 25.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pika 3 ndryshohet dhe shtohet pika 3/1, si më poshtë vijon:

"3. Leja minerare është nënkategoria IV.1.B, e cila trajtohet sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t'iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL-ja, për secilën nga llojet specifike të kësaj lejeje janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni minerar në fuqi.

3/1. Lejet minerare specifikohen si vijon:

- a) "Leje kërkim-zbulimi" me kodin IV. 1. B. 1;
- b) "Leje shfrytëzimi" me kodin IV. 1. B. 2;
- c) "Leje kërkim-zbulim-shfrytëzimi" me kodin IV. 1. B. 3.". Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Copyright 2015 - www.ligjet.org